



Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

GJEOPORTALI

Manuali i Përdoruesit

Versioni i manualit të përdoruesit: 2.1.0

Data e modifikimit të fundit: 4.18.2024

TABELA E PËRMBAJTJES

PREZANTIM I SISTEMIT	7
NDËRFAQJA DHE FUNKSIONALITETET E GJEOPORTALIT	7
IDENTIFIKIMI	9
REGJISTRIMI I PËRDORUESEVE	9
RISHIKIMI I FJALËKALIMIT	10
MODIFIKONI TË DHËNAT E PËRDORUESIT	11
NDRYSHONI FJALËKALIMIN	11
HARTA	11
HARTË PËRMBLEDHËSE	12
MJETET E NAVIGIMIT NË HARTË	13
Hartë përmbledhëse	13
Pamje e plotë.....	13
Vendndodhja e përdoruesit.....	13
Zmadho në shtrirje	13
Zmadho me drejtkëndësh	13
Pamja e mëparshme	13
Pamja tjetër	14
Kalo në pamjen 3D	14
Rrjeti koordinativ	14
Zmadho	14
Mat lartësinë e terrenit.....	14
Ndërtesa 3D	14
Niveli i zmadhimit.....	15
Zvogëlo	15
Pema e shtresave	15
Tabela Te gjitha.....	15
Tabela me Temat	16
Tabela e shtresave aktive	16
Butoni i opsioneve të shtresave	16
Grupi i shtresave	16
Zgjero grupin e butonave të shtresave	16
Shtresat jo aktive	16
Transparenca	16
Menuja kontekstuale e shtresave	16
Butoni i aktivizimit të shtresës.....	16
Butoni i informacionit të shtresës	16
Zmadho tek shtresa	16
Shenja e dukshmerise së shtresës	16
Butoni i hapjes së menuse kontekstuale	17
Butoni i mbylljes së menuse kontekstuale	17
Butoni i eksportimit të të dhënave të shtresës	17
Butoni i modifikimit të shtresës lokale	17
Butoni i fshirjes se shtreses lokale.....	17
Opsionet e shtresave	17
Butoni i temës.....	17
Katalogu i selektuar	17

Butoni i pamjes së kategorizuar	17
TEMAT	18
Mjetet	18
Mjetet e selektimit	18
Identifikimi	18
Zmadhimi sipas koordinatave	18
Mjetet e matjeve	19
Mjetet e vizatimeve	19
Permalink	19
Shto shtrese	19
Kërkim	19
Aplikacioni 360	19
Gjeo-referencimi	19
Selektimi	19
Selektim i thjeshtë	20
Selektim hapësinor	20
Atributet e tipareve	20
Printim i hartës së pronës	20
Modifiko tiparet	20
Zmadhim tek selektimi	21
Fshi selektimin	21
Selektim i thjeshtë	21
Selektim hapësinor	22
Tipi i selektimit	23
Tipi i kryqëzimit	23
Atributet e tipareve	23
Printimi i hartës së pronës	24
Printimi i hartës së pronës	24
Modifikimi i tipareve	25
Selektimi i projeksionit	25
Forma e koordinatave	25
Identifikimi	26
Identifikim me pike	26
Identifikim me drejtkëndësh	26
Zmadho	27
Zmadho me koordinata	27
Shfaq koordinatat	27
Mat	27
Mat me gjerësi	28
Mat sipërfaqe	28
Fshi matjen	28
Vizato	28
Vizato një pikë	28
Vizato një pikë me koordinata	29
Vizato një vijë	30
Vizato një poligon	30
Vendos një shënim	31

Fshi vizatimin	31
Printimi	31
Titulli i dokumentit	32
Shkalla	32
Orientimi	33
Formati	33
Madhesia e letres	33
Butoni PRINTO	33
Printimi me Vule Digjitale	33
Permalink	35
URL	36
Kopjo linkun	36
Kodi QR	36
Informacione te pergjithshme	36
Dergojeni	36
Shto shtresë	36
Shto një shtresë lokale	36
Ngarkoni një shtresë WMS/WFS/WMTS	36
Shto një shtresë lokale	37
Shto një tipar të ri	38
Ngarkimi i një shtrese WMS/WFS/WMTS	39
Kërko	40
Kërkimi tekst	40
Kërkim i avancuar	41
Opsionet e kërkimit	44
Qëllimi i kërkimit	44
Aplikacioni 360	45
Pamja 360	46
Gjeo-referencimi	46
Caktimi i pikave te gjeoreferencimit	47
Shtimi i dosjeve hapësinore të të dhënave në hartë duke përdorur metodën e Drag and Drop	48
Pamja 3D e hartës	49
NDËRFAQJA DHE FUNKSIONALITETET E GJEOPORTALITIT PËR	
VERSIONIN MOBILE	50
Identifikimi	52
Krijo një llogari	52
Harro fjalëkalimin	52
Regjistrimi i përdoruesve	53
Rishikimi i fjalëkalimit	54
Harta	54
Shkalla	55
Legjenda e shtreses	55
Hartë përmbledhëse	55
Mjetet e navigimit në hartë	56
Harta e përgjithshme	56
Zmadho në masë	56

Ekran i plotë.....	56
Niveli i zmadhimit.....	56
Zvogëloni	57
Pema e shtresave	57
Te gjitha.....	57
Temat	57
Aktive.....	57
Butoni i opsioneve te pemes se shtresave	57
Gruper e shtresave	57
Zgjero butonin e grupit të shtresave	58
Shtresat joaktive	58
Trasparenca	58
Menuja kontekstuale e Layer-it.....	58
Butoni i aktivizimit të shtresës.....	58
Butoni i informacionit mbi shtresën	58
Zmadho në butonin e shtresës	59
Opsionet e pemës së shtresave.....	59
Butoni i temës.....	59
Katalogu i përzgjedhur.....	60
Butoni i kategorizimit të pamjes	60
Temat.....	60
Mjetet.....	61
Identifiko	61
Zmadho me koordinata.....	61
Matja e gjatesisë.....	61
Matja sipërfaqes	61
Fshi matjen	61
Permalink.....	62
Kërko	62
Identifiko	62
Identifiko me pike.....	62
Identifiko me drejtkendesh.....	62
Rezultate	63
Permalink.....	63
URL	64
Kopjo link	64
Kodi QR	64
Informacion i pergjithshem.....	65
Dergo.....	65
Kërkimi.....	65
Kërko tekstin.....	66
Rezultatet e kërkimit	66
Kërkim i avancuar	66
Kërkim i avancuar	66
Lloji i kërkimit	67
Opsionet e kërkimit.....	67
Qëllimi i kërkimit	68


Tipi i kërkimit.....	68
Kërkim i lirë.....	68
Kërkim i përcaktuar.....	68
Input i filtrit të ri	69
Opsionet e kërkimit.....	69
Çdo tekst	69
Përputhje ekzakte.....	69
Negative	69
Frazë	70
Qëllimi i kërkimit	70
Të gjitha.....	70
Objektet e përzgjedhura	70
Pamja aktuale e hartës	70
Formë e përcaktuar	70

PREZANTIM I SISTEMIT

Gjeoportali i ASIG përdor cilësi të avancuara të teknologjisë [HTML5](#). Browser-i i rekomanduar për t'u përdorur është versioni i fundit i Google Chrome. Për të funksionuar sa më saktë, duhet të aktivizoni [cookies](#).

NDËRFAQJA DHE FUNKSIONALITETET E GJEOPORTALIT

Ndërfaqja e Gjeoportalit përmban disa menu kryesore, të cilët përfshijnë kreun, pemën e shtresave, menunë e mjeteve, hartën, opsionet e mjeteve, mjetet e navigimit në hartë dhe footer-in.



1

Kreu

Kreu përmban logon e ASIG dhe lidhjet me seksione të ndryshme të Geoportalit si temat, të dhënat, shërbimet, lajmet, NSDI, ndihma dhe butoni i identifikimit.

2

Harta

Harta është baza e ASIG Geoportal. Tregon në mënyrë interaktive dhe lejon ndërveprimin me të dhënat hapësinore. Funkcionalitetet e hartës janë përshkruar në detaje në kapitullin **Harta**.

3 Toolbari i navigimit në hartë

Toolbari i lundrimit ne harte përmban mjete të përdorura për navigimin në hartë. Funkcionalitetet e shiritit të toolbarit së lundrimit ne harte janë përshkruar në hollësi në kapitullin e Mjetet e navigimit në hartë.

4 Shtresat

Pema e shtresave përmban listën e shtresave me shtresën dhe opsionet e temave. Ajo është e vendosur në anën e majtë të ndërfaqes Geoportal. Për të hapur pemën e shtresës, klikoni mbi ikonën SHTRESA ose tekstin. Funkcionet e pemës së shtresës janë përshkruar në detaje në kapitullin e Pema e Shtresave.

SHTRESAT	
TË GJITHA	TEMAT
AKTIVE	
Vendime të K.M.	+
KRGJSH	+
Kufijtë e Njësive Administra...	+
Ortoimazheria	+
Imazhi i Hartave Bazë	+
Modeli Dixhital i Terrenit	+
Parcelat Kadastrale	+
Sistemi i Adresave	+
Ndërtesat	+
Infrastruktura Urbane dhe S...	+
Hidrografia	+
Mbulesa e Tokës	+
Përdorimi i Tokës	+
Burimet Energjetike	+
Burimet Minerare	+




5 Toolbari



Toolbari përmban mjete për kërkimin dhe manipulimin e të dhënave. Ndryshimi i gjuhës së ndërfaqes së përdoruesit dhe të dhënave duke zgjedhur gjuhën e dëshiruar në anën e djathtë të shiritit të veglave. Funksionet e toolbarit përshkruhen në detaje në kapitullin e Mjetet.

6 Opsione

Paneli i opsioneve të veglave përmban opsionet e veglave për mjetin ose grupin e përzgjedhur të mjeteve dhe ndihmën interaktive të mjeteve. Është gjithashtu një vend ku do të shfaqet kërkimi i të dhënave hapësinore dhe rezultatet e identifikimit.



7 Footer



Platforma Geoportal përmban shkurtore për mjetin e kërkimit Kerkimi, informacionin për ASIG, formularin e kontaktit dhe kushtet e përdorimit.

IDENTIFIKIMI

Kliko butonin  në anën e djathtë të kreut për tu identifikuar në Gjeoportal. Ne ekran do të shfaqet dritarja e mëposhtme për të vendosur të dhënat për identifikim.



Gjeoportali Kombëtar i ASIG
Vendosni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për të hyrë në Gjeoportalin Kombëtar

Ju lutem plotësoni [Shoqe](#) | [English](#)

Emri i përdoruesit:

Fjalëkalimi:

HYR FSHIJ

[Hyr nga e-albania](#) | [Krijoni një llogari](#) | [Harrova fjalëkalimin](#)

Për arsye sigurie, [dihni](#) nga shfletuesi juaj kur të jeni duke aksesuar në shërbime që kërkojnë autentifikim!

Emri i përdoruesit: Kjo fushë plotësohet me emrin e përdoruesit për identifikim.

Fjalëkalimi: Kjo fushë plotësohet me fjalëkalimin e përdoruesit për identifikim.

Hyr: Kliko këtë buton për të mbyllur procesin e identifikimit, pasi janë mbushur fushat me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin.

Fshij: Kliko këtë buton për të fshirë fushat e përdoruesit dhe fjalëkalimin.

Hyr nga e-albania: Kliko këtu për t'u identifikuar përmes portalit e-albania.

Krijoni një llogari: Kliko këtu për të krijuar një llogari të re për përdorues. Lexo më shumë mbi këtë funksionalitet në kapitullin Regjistrimi i Përdoruesve.

Harrova fjalëkalimin: Kliko këtu nëqoftëse keni harruar fjalëkalimin e llogarisë. Lexo më shumë mbi këtë funksionalitet në kapitullin Rishikimi i fjalëkalimit.

REGJISTRIMI I PËRDORUESEVE

Për të regjistruar llogarinë e përdoruesit ju duhet të plotësoni të dhënat tuaja personale dhe të dhënat tuaja të punësimit dhe të dërgoni kërkesën për regjistrim tek administratori i sistemit.

Regjistrimi i përdoruesit

Emri i përdoruesit *

Fjalëkalimi *

E-mail *

Emri

Mbiemri

Adresa

Qyteti

Kodi postar

Shteti

Numri i telefonit

Numri i telefonit mobil

Pozicioni i punës

☐ I'm not a robot 

Regjistrohuni

Pasi të keni vendosur të gjitha të dhënat e kërkuara, konfirmoni që nuk jeni robot (reCAPTCHA) dhe klikoni butonin Regjistrohu. Ju do të merrni një e-mail duke thënë se kërkesa juaj e llogarisë është dërguar tek administratori i sistemit. Më pas do të njoftoheni me e-mail kur administratori i sistemit të aktivizojë llogarinë tuaj.

3

Fushat e detyrueshme:

Gjatë regjistrimit të përdoruesit, fushat e detyrueshme për t'u plotësuar, janë të shenjura me yll. (*)

Informacione mbi përdoruesin:

Shkruani informacionin tuaj personal dhe të punësimit në fushat e ofruara.

reCAPTCHA validim:

reCAPTCHA është një shërbim falas që mbron vendin nga spam dhe abuzimi. Kliko kutinë për të provuar se nuk jeni robot.

Regjistrohuni:

Klikoni mbi këtë buton për të përfunduar procedurën e regjistrimit të llogarisë.

RISHIKIMI I FJALËKALIMIT

Kliko linkun **Rivendos fjalëkalimin** tek Identifikimi për të fshirë fjalëkalimin e llogarisë. Shkruani emailin që lidhet me llogarinë tuaj dhe klikoni butonin “Reset Password” për të rivendosur fjalëkalimin. Ju do të merrni një email me fjalëkalimin e ri.

Rivendos fjalëkalimin

E-mail

Rivendos fjalëkalimin

E-mail: Vendorsni emailin e lidhur me llogarinë tuaj.

Rivendos fjalëkalimin: Klikoni këtë buton për të përfunduar procedurën e rishikimit të fjalëkalimit.

MODIFIKONI TË DHËNAT E PËRDORUESIT

Ndrysho të dhënat e përdoruesit

Emri i përdoruesit	perdorues_test
E-mail	perdorues.test@test.com
Emri	Test
Mbiemri	user
Adresa	Tirane
Qyteti	Tirane
Kodi postar	Kodi postar
Shteti	Shteti
Numri i telefonit	Numri i telefonit
Numri i telefonit mobil	Numri i telefonit mobil
Pozicioni i punës	Pozicioni i punës
Kodi i aksesit	6f845f45ff-d9745-54sg-4sgv446846444

Update

Ndryshoni fjalekalimin
Harruat fjalekalimin?

Përdoruesi mund të modifikojë të dhënat e veta si emri, mbiemri, adresa, numri i telefonit etj. Për të ndryshuar të dhënat e përdoruesit, përdoruesi klikon në emrin e përdoruesit në krye të portalit.

Perdorues Test

Në këtë formë, përdoruesi mund të ndryshojë fjalëkalimin e vet dhe të kërkojë fjalëkalimin e ri nëse harron fjalëkalimin ekzistues. Përdoruesi nuk mund të ndryshojë emrin e përdoruesit dhe e-mailin.

Informacion i ndryshueshëm:

Përdoruesi mund të ndryshojë çdo informacion përveç Emrit dhe E-mail.

Përditëso

Klikoni këtë buton për të ruajtur ndryshimet e bëra në të dhënat e përdoruesit.

Ndrysho fjalëkalimin

Klikoni në këtë fushë për të ndryshuar fjalëkalimin.

Harrove fjalëkalimin

Klikoni në këtë fushë për të rishikuar fjalëkalimin.

NDRYSHONI FJALËKALIMIN

Përdoruesi mund të ndryshojë fjalëkalimin. Rregulli i vetëm është që fjalëkalimi duhet të ketë të paktën 6 karaktere. Kjo është veçori e vogël sidomos pas rivendosjes së fjalëkalimit, sepse fjalëkalimi i ri që është pranuar me postë elektronike është i gjatë dhe i komplikuar.

Për të ndryshuar fjalëkalimin, shkruani fjalëkalimin e vjetër, fjalëkalimin e ri, përsëritni fjalëkalimin e ri dhe klikoni mbi butonin “**Konfirmo fjalëkalimin**”.

Fjalekalimi ndryshoi

Fjalekalimi i vjetër	
Fjalekalimi i ri	
Përsëritni fjalekalimin	

Konfirmo fjalekalimin Anullo ndryshimet

Fjalëkalimi i vjetër: Shkruani fjalëkalimin aktual.

Fjalëkalimi i ri: Shkruani fjalëkalimin e dëshiruar të ri në këtë fushë

Përsërit fjalëkalimin: Përsëritni fjalëkalimin e ri këtu.

Konfirmo fjalëkalimin: Klikoni mbi këtë buton për të konfirmuar fjalëkalimin e ri.

HARTA

Harta është baza e ASIG Geoportal. Tregon në mënyrë interaktive dhe lejon ndërveprimin me të dhënat hapësinore.



Ikona e hartës bazë



Zgjidhni nga përzgjedhje të ndryshme të hartave bazë duke klikuar widget basemap.

Projeksioni



Zgjidh sistemin koordinativ për shfaqjen e koordinatave.

Pozicioni i kursorit te mujt (mouse)

482433.000, 4580446.000


Koordinatat e kursorit përzgjidhen tek Harta.

Shkalla e zmadhimit



Linja e shkallës tregon lidhjen midis distancës në hartë dhe distancës në botën reale në sistemin metrik.

Legjenda e shtresave



Legjenda e shtresës tregon simbolin e shtresës në mënyrë që ju të mund t'i dalloni vizualisht objektet nga shtresat e ndryshme në hartë. Legjenda e shtresave tregon simbolet vetëm për shtresa aktualisht të dukshme.

HARTË PËRMBLEDHËSE

Harta përmbledhëse ndihmon navigimin në hartë. Harta e përgjithshme sinkronizohet me hartën kryesore. Zvarritja dhe zmadhimi i hartës kryesore do të lëvizë treguesin e shtrirjes së shikimit në hartën e përgjithshme dhe anasjelltas.



Për të mbyllur hartën e përgjithshme, kliko kudo në zonën e hartës së përgjithshme ose ikonën e hartës së përgjithshme në linkun Mjetet e navigimit në hartë.

MJETET E NAVIGIMIT NË HARTË

Mjetet e navigimit në hartë shërbejnë për navigimin në hartë.

Hartë përmbledhëse



Harta përmbledhëse ndihmon navigimin në hartë duke shfaqur shtrirjen kryesore të hartës në shkallën më të vogël. Lexo më shumë mbi këtë funksionalitet në kapitullin Mjetet e navigimit në hartë.

Pamje e plotë



Kalon Geoportalin në regjimin me ekran të plotë. Kreu dhe footer-i janë të fshehura në mënyrë të plotë në ekran për të maksimizuar hapësirën e dritares në dispozicion të hartës.

Vendndodhja e përdoruesit



Shfaq vendndodhjen aktuale të përdoruesit në hartë. Sistemi mundëson marrjen e koordinatave të vendndodhjes në hartë përmes GPS nëse pajisja nga e cila po akseson ka GPS, në të kundërt nëpërmjet IP-së nga WIFI ose rrjetit LAN.

Zmadho në shtrirje



Kliko për të zmadhuar në shtrirjen maksimale të hartës.

Zmadho me drejtkëndësh



Aktivizon zmadhimin në masë duke nxjerrë një drejtkëndësh në hartë. Klikoni dhe mbani butonin e majtë të mouse-it dhe tërhiqni për të nxjerrë një drejtkëndësh. Lëshimi i butonit të majtë të mouse-it do të ndalojë zmadhimin në drejtkëndëshin e tërhequr.

Pamja e mëparshme



Kliko për të rivendosur pamjen e mëparshme të hartës. Butoni i mëparshëm do të bëhet aktiv kur ka gjendje në dispozicion për t'u rikthyer dhe do të bëhet joaktive kur nuk ka gjendje për të rivendosur.



Pamja tjetër



Kliko për të rivendosur pamjen e ardhshme të hartës. Butoni tjetër do të bëhet aktiv kur ka gjendje në dispozicion për t'u rikthyer dhe do të bëhet joaktive kur nuk ka gjendje që të rivendosen.

Kalo në pamjen 3D



Aktivizon pamjen 3D të hartës dhe mundëson kalimin në 2D.



Rrjeti koordinativ



Një rrjet që përfaqësojnë meridianet dhe paralelet.

Zmadho



Kliko për të zmadhuar në hartë.

Mat lartësinë e terrenit



Kliko për të marr lartësinë e terrenit në pozicionin e mausit mbi hartë.

Ndërtesa 3D



Kliko për të aktivizuar pamjen 3 D në hartë.

Niveli i zmadhimit

Çdo pikë paraqet një nivel të zmadhimit të hartave, ndërsa pika e portokalli është niveli aktual i zmadhimit. Klikoni pikat për të ndryshuar nivelin e zmadhimit të hartës. Në Nivelet e zmadhimit të hartës së gjeoportalit është mundësuar edhe niveli i zmadhimit 1:250, i cili aksesohet duke klikuar pikën me të njëjtën label (1:250).



Zvogëlo

Kliko për të zvogëluar në hartë.



Pema e shtresave

Pema e shtresave ju lejon të shihni shtresat e botuara në Geoportal. Ai siguron shumë funksionalitete: duke e bërë një shtresë ose grup shtresash të dukshme ose të padukshme, rregullimin e transparencës së shtresës, përzgjedhjen e shtresës aktive, informacionin e shtresës dhe më shumë.




Tabela Te gjitha

Të gjitha shtresat në dispozicion në sistem shfaqen në këtë skedë.

Tabela me Temat

Të gjitha shtresat për temën e përzgjedhur aktualisht shfaqen nën këtë skedë. Lexo me shume mbi kete funksion ne kapituj Opsionet e shtresave dhe Temat.

Tabela e shtresave aktive

Të gjitha shtresat aktualisht të dukshme në hartë shfaqen nën këtë skedë.

Butoni i opsioneve të shtresave

Ky buton hap menunë e opsioneve të pemës së shtresës. Lexo me shume mbi kete funksion ne kapitullin Opsionet e shtresave .

Grupi i shtresave

Ky është një shembull i një grupi të shtresës së shembur. Një klikim në simbol + pranë emrit të grupit të shtresës do ta zgjerojë atë.

Zgjero grupin e butonave të shtresave

Një grup shtresash zgjerohet duke klikuar mbi këtë buton. Kur të zgjerohet, do të shfaqen të gjitha shtresat brenda grupit.

Shtresat jo aktive

Ky është një shembull i një shtrese joaktive. Ekziston një shenjë me ngjyrë të errët në frontin e shtresës dhe menyja kontekstuale e shtresës nuk është e dukshme. Kjo shtresë dhe karakteristikat e saj dhe aktualisht nuk janë të dukshme në hartë.

Transparenca

Transparenca e shtresës, 0% - 100%.

Menuja kontekstuale e shtresave

Menuja kontekstuale e shtresës përmban opsione të tilla si transparencë, përzgjedhje aktive e shtresave, informacion mbi shtresat dhe më shumë.

Shenim: Menutë kontekstuale mund të ndryshojnë për disa lloje shtresash, por të gjitha opsionet e mundshme janë përmendur në këtë kapitull.

Butoni i aktivizimit të shtresës

Mjete të caktuara (mjete vizatimi për shembull) do të kërkojnë që një shtresë të jetë aktive para se të mund të përdoren. Një shtresë mund të vendoset si aktive duke klikuar këtë buton. Nëse një shtresë është aktive, butoni do të ketë një shenjë portokalli. Vetëm një shtresë mund të jetë aktive në të njëjtën kohë. Nëse një shtresë aktivizohet, një shtresë më parë aktive (nëse ka) do të çaktivizohet automatikisht.

Butoni i informacionit të shtresës

Kur klikohet ky buton, do të afishohet një listë me informacionin e shtresës që ju mundëson të shihni informacione të ndryshme si legjenda e shtresës, metadatave dhe shërbimet



Zmadho tek shtresa

Kur klikohet, harta do të zmadhohet në shtrirjen e shtresës, duke e bërë të gjithë shtresën e dukshme në hartë.

Shenja e dukshmerise së shtresës

Një shtresë aktualisht e dukshme në hartë do të ketë një shenjë të portokalli, ndërsa shenja e një shtrese të padukshme do të jetë gri.

Butoni i hapjes së menisë kontekstuale

Një klikim në këtë buton hap menunë kontekstuale të shtresës. Butoni është i dukshëm vetëm nëse shtresa aktualisht është e dukshme (shenja portokalli në anën e majtë të emrit të shtresës).

Butoni i mbylljes së menisë kontekstuale

Duke klikuar këtë buton, do të mbyllet menyja kontekstuale e shtresës.

Butoni i eksportimit të të dhënave të shtresës

Ky opsion shfaqet vetëm për shtresa vektoriale dhe ju mundëson të eksportoni të dhënat e shtresës.

Butoni i modifikimit të shtresës lokale

Ky opsion shfaqet vetëm për shtresat lokale dhe mundëson modifikimin e një klase lokale të funksionit. Lexo me shume mbi kete funksion ne kapitullin.

Butoni i fshirjes se shtreses lokale

Ky opsion shfaqet vetëm për shtresat lokale dhe ju mundëson të fshini shtresen lokale.

Opsionet e shtresave

Menuja e opsioneve të përmes së shtresave ju mundëson të zgjidhni një temë dhe të ndryshoni pamjen e përmes së shtresës.



Butoni i temës

Duke klikuar këtë buton do të shfaqet një dritare modale me një përzgjedhje të temave nga të cilat mund të zgjidhni. Emri i butonit reflekton temën e përzgjedhur aktualisht.

Katalogu i selektuar

Shfaq katalogun e përzgjedhur aktualisht. Këto butona kanë saktësisht funksionin e njëjtë si skedat e shtresës TE GJITHA / TEMA / AKTIVE.

Butoni i pamjes së kategorizuar

Duke klikuar këtë buton, do të aktivizoni ose çaktivizoni pamjen e kategorizuar të shtresave në pamjen e shtresës. Pamja e kategorizuar (e aktivizuar nga default) do të shfaqë shtresat në grupet e tyre. Kur të çaktivizohet, të gjitha shtresat do të shfaqen në një listë të vetme dhe të sheshtë. Një shenjues portokalli do të shfaqet kur të jetë i aktivizuar shikimi i kategorizuar.

TEMAT

Temat janë grupe shtresash që ndajnë një temë të përbashkët, për shembull: Hidrografia, Hartat historike, Gjeologjia, Përdorimi i tokës etj. Megjithëse të gjitha shtresat e temës të gjitha tashmë të pranishme në skedën TE GJITHA në pemën e shtresës, ky funksionalitet ju jep mundësi të filtroni shtresat me një temë të zgjedhur dhe i shfaqni ato në skedën TEMA në pemën e shtresës.



Funksioni i zgjedhjes së temës është dhënë në kapitullin Opsionet e shtresave. Duke klikuar butonin e përzgjedhjes së temës do të shfaqet një dritare siç tregohet më lart dhe ju mund të zgjidhni një temë duke klikuar në tablonë e saj.

Mjetet

Ky kapitull përshkruan përdorimin e mjeteve në dispozicion në Geoportal.



Mjetet e selektimit



Përzgjedh mjetet që përdoren për zgjedhjen dhe shkarkimin e objekteve në hartë. Lexoni më shumë për këtë funksion në kapitullin Selektimi.

Identifikimi



Ky mjet ju jep mundësinë për të identifikuar objekte nga të gjitha shtresat e dukshme në hartë. Lexoni më shumë për këtë funksion në kapitullin Identifikimi.

Zmadhimi sipas koordinatave



Zmadhon hartën në koordinatat e dhëna. Ju mund të zgjidhni Sistemin Koordinativ të Referimit për shkrimin e koordinatave.

Mjetet e matjeve

 Ju mund të matni gjatësinë ose zonën duke zgjedhur mjetin e duhur në panelin e opsioneve të NDËRFAQJA DHE FUNKSIONALITETET E GJEOPORTALIT Pas aktivizimit të këtij mjeti, klikoni butonin e majtë të mouse-it kudo në hartë për të filluar të vizatoni një vijë / poligon. Çdo klikim i majtë pasues shton një pikë të re në vijën / poligonin. Klikoni dy herë për të përfunduar vizatimin e vijës / poligonit. Vlerat e matura shfaqen në objektet e matura të matjes.

Mjetet e vizatimeve

 Me mjete vizatimi, mund të vizatoni lloje të ndryshme të objekteve të gjeometrisë në hartë. Lexoni më shumë për këtë funksion në kapitullin Vizatim.

Permalink

 Me mjetin permalink, mund të krijoni, ruani dhe ndani URL ose kodin QR, i cili përmban informacione rreth pamjes aktuale të hartës. Informacioni rreth pamjes së hartë përmban pozicionin e hartës, nivelin e zmadhimit, listën e shtresave me informacion rreth dukshmërisë së tyre dhe transparencës.

Shto shtrese

 Mjete për shtimin e llojeve të ndryshme të shtresave në pemën e shtresës. Lexoni më shumë për këtë funksion në kapitulli, Shto shtresë.

Kërkim

 Mjeti Kërkim ju lejon të kërkoni objekte nga shtresa në bazën e të dhënave duke shtypur ose përzgjedhur termin e dëshiruar dhe duke përcaktuar parametra të tjerë si qellimi i kërkimit. Lexoni më shumë për këtë funksion në kapitullin Kërkimi.

Aplikacioni 360

 Mjeti Aplikacioni 360 ju lejon për t'u lidhur dhe për të hyrë në aplikacionin 360 gradë direkt në Web Viewer. Lexoni më shumë për këtë funksion në kapitullin Aplikacioni 360.

Gjeo-referencimi

 Mjeti Gjeo-referencimi ju shërben për ngarkimin dhe gjeoreferencen e imazheve në hartë si dhe eksportimin e imazhit të gjeoreferencuar Lexoni më shumë për këtë funksion në kapitullin Gjeo-referencimi.

Selektimi

Mjeti Selektim është një sërë mjetesh për zgjedhjen, shkarkimin, fshirjen dhe redaktimin e veçorive. Për të selektuar ndonjë nga veçoritë nga një shtresë e caktuar, duhet të aktivizoni shtresën në pemën e shtresës (për aktivizimin e shtresës, shih kapitullin Pema e Shtresave). Nëse nuk aktivizohet shtresa, shtresa e përkohshme do të përdoret për përzgjedhje.

Shenim: Disa mjete selektimi janë në dispozicion vetëm për përdorues të regjistruar.



 I thjeshtë

Selektim i thjeshtë

Përdoreni këtë mjet për të zgjedhur një veçori thjesht duke klikuar mbi të me anë të miut. Për të zgjedhur më shumë objekte në hartë, shtypni dhe mbani shtypur butonin SHIFT në tastierë dhe klikoni mbi objekte të tjera. Për të shmangur objektin nga përzgjedhja, shtypni dhe mbani shtypur SHIFT në tastierë dhe klikoni mbi objektin e zgjedhur.

Selektim hapësinor

 Hapësinor

Ky mjet ju mundëson të zgjidhni një objekt në hartë duke vizatuar poligonin në zonën e dëshiruar të hartës. Lexoni me shume mbi kete funksionne kapitullin Selektim hapësinor.

Atributet e tipareve

 I thjeshtë atributet e tipar...

Ju mund të shikoni atributet e tipareve duke klikuar mbi objektin në hartë. Lexoni me shume mbi këtë funksion në kapitullin Atributet e tipareve.

Printim i hartës së pronës

 Printo hartën e pronës

Ju mund të shkarkoni tipare te zgjedhura në formatin Shapefile ose GML. Ky mjet perdoret vetem nga perdorues te regjistruar.

Modifiko tiparet

 Modifiko tiparet

Me këtë mjet, ju mund të ndryshoni gjeometrinë e tipareve. Lexoni më shumë mbi këtë funksion në kapitullin Modifikimi i tipareve.

Zmadhim tek selektimi

X ZMADHO TEK SELEKTIMI

Pas zgjedhjes së tipareve, mund të zmadhoni hartën në tiparet e zgjedhura duke klikuar me mouse-in në këtë fushë.


Fshi selektimin

X FSHI SELEKTIMIN

Për të fshirë tiparet e zgjedhura, klikoni në këtë fushë.


Selektim i thjeshtë

Ju mund të zgjidhni objekte nga shtresa e përkohshme. Për të zgjedhur objekte nga një shtresë tjetër, aktivizoni shtresën e dëshiruar në Pema e Shtresave.



Selektim hapësinor

Ky mjet ju mundëson të selektoni një objekt në hartë duke vizatuar poligonin në zonën e dëshiruar të hartës. Ju mund të zgjidhni forma të ndryshme të poligonit për zgjedhjen dhe mund të përcaktoni llojin e selektimit - interseksion ose perbrenda.



Tipi i selektimit

Mund të zgjidhni formën e poligonit për të selektuar veçoritë.



TIPI I SELEKTIMIT

☒ POLIGON

☐ RRETH

Tipi i kryqëzimit

Ju mund të përcaktoni llojin e kryqëzimit. Nëse zgjidhet opsioni i kryqëzimit, të gjitha objektet që preken nga poligoni gjatë selektimit do të përfshihen në selektim. Nëse zgjidhet opsioni brenda, do të shfaqen vetëm rezultatet brenda poligonit.

☐ DREJTKENDE

TIPI I KRYQEZIMIT

Atributet e tipareve

Me këtë mjet mund t'i shikoni atributet e dëshiruara. Për të parë atributet e funksionit, së pari aktivizoni shtresën nga e cila dëshiron të shohë atributet e objektit dhe pastaj klikoni mbi objektin e dëshiruar për të parë atributet.

Shënim: Per aktivizimin e shtresës, shiko në Pema e Shtresave.




Pas klikimit mbi objektin e dëshiruar, shfaqet dritarja me attribute të funksioneve. Nëse nuk gjenden rezultate, do të shfaqet mesazhi i duhu



Printimi i hartës së pronës

Opsioni i printimit të hartës së pronës jep mundësinë për të printuar parcela të zgjedhura të vetme në formatin pdf.



Printimi i hartës së pronës

Selekto një paketë nga shtresa e Parcelave për të printuar dhe kliko në printo për të printuar hartën e pronës.

Modifikimi i tipareve

Ju mund ta përdorni këtë mjet për të modifikuar tipare vektoriale nga shtresa aktive. Pas aktivizimit të mjetit ju mund të zgjidhni dhe të modifikoni ndonjë tipar në shtresën aktive. Nëse nuk aktivizohet shtresa, shtresa e përkohshme do të përdoret për përzgjedhje. Tipari mund të modifikohet ose nga funksioni drag and drop ose nga koordinatat e modifikuara në formën e modifikuar të koordinatave.

Shënim: Për aktivizimin e shtresës, shiko në Pema e Shtresave.



Selektimi i projeksonit

Zgjidhni projeksonin e koordinatave.



Forma e koordinatave

Mund të ndryshoni koordinatat (X, Y) dhe më pas shtypni LEVIZ.



Identifikimi

Ky mjet ju jep mundësinë për të identifikuar objekte nga të gjitha shtresat e dukshme në hartë. Ka dy mënyra për të identifikuar objekte:

Nga pika ku ju klikoni në vendin e dëshiruar në hartë

Nga drejtkëndësh ku vizatoni drejtkëndëshin në hartë dhe identifikon të gjitha objektet që prekin drejtkëndëshi.



IDENTIFIKO ME PIKË

Identifikim me pike

Zgjidhni këtë funksion për të identifikuar objektet në hartë sipas pikës.

IDENTIFIKO ME DREJTKËNDËSH

Identifikim me drejtkëndësh


Zgjidhni këtë funksion për të identifikuar objektet në hartë nga drejtkëndëshi.

Rezultatet

- REZULTATE

Rendi 1 (Shteti)	1
Rendi 2 (Qark)	1

Pasi të bëhet identifikimi, rezultatet do të shfaqen në zonën Rezultate. Rezultatet tregohen si një listë me shtresa të dukshme me një numër tiparësh të gjetura (p.sh. në shembullin e mësipërm mund të shohim se identifikimi bëhet në shtresat 'Rendi i parë (Shteti)' dhe 'Rendi i dytë (Qark)' dhe çdo shtresë ka 1 tipar). Për të parë më shumë hollësi rreth veçorive të shtresave, mund të klikoni mbi emrin e shtresës. Pas klikimit mbi emrin e shtresës, një listë me tipare të identifikuar brenda një shtrese do të zgjerohet dhe mund të zgjidhni funksionin e dëshiruar për të parë tiparet e tij. Tipari i



zgjedhur është i theksuar me të kuqe në hartë.

Zmadho

Ky mjet ju jep mundësinë të zmadhoni koordinatat ose të tregoni koordinatat e një pike të caktuar të zgjedhur.



Zmadho me koordinata

Ky mjet përdoret për të zmadhuar në një pikë specifike duke përcaktuar projektimin dhe koordinatat e duhura.

Shfaq koordinatat

Duke klikuar në hartë, ju mund të merrni koordinatat e pikës.

Mat

Ky mjet përdoret për të matur gjatësinë ose zonën duke shtypur në hartë për të filluar matjen dhe për të lëvizur kursoren në drejtim të matjeve. Për të ndaluar matjen, klikoni dy herë butonin e majtë të mouse-it në vendndodhjen në të cilën keni ndërmend të ndaloni.



Mat me gjeresi

Ky mjet përdoret për të matur gjatësinë midis pikave të zgjedhura.

Mat sipërfaqe

Ky mjet përdoret për të matur zonën e zgjedhur.


Fshi matjen

Duke përzgjedhur këtë mjet ju mund të pastroni të gjitha matjet.

Vizato


Me mjete vizatimi, mund të vizatoni lloje të ndryshme të objekteve të gjeometrisë në hartë. Para vizatimit, duhet të zgjidhni shtresën aktive ku do të shtohet një tipar i ri. Nëse nuk aktivizohet shtresa, do të përdoret shtresa e përkohshme.

Shenim: Per aktivizimin e shtreses , shiko kapitullin Pema e Shtresave.



Vizato një pikë

Mjet për të nxjerrë pikat në hartë. Për të nxjerrë pikë, aktivizoni mjetin, përcaktoni rrezet e pikës, madhësinë e linjës, plotësoni dhe ngjyrën e vijës, mbushni dhe mbivendosni vijën dhe më pas përdorni butonin e majtë të miut në hartë për të nxjerrë funksionin e ri.



Vizato një pikë me koordinata

Mjet për vizatimin e pikave me anë të koordinatave në hartë. Për të vizatuar pikë në koordinatat, zgjidhni fillimisht projektimin, shkruani koordinatat në kutinë e futjes dhe pastaj klikoni mbi butonin VIZAT

Vizato

Vizato një pikë me...

PROJEKSIONI

☒ KRGJSH

UTM ZONE 34N

ALBANIAN 1986/GK4

ETRS89/TM34

WGS 84

WEB MERCATOR

Vizato një vijë

Mjet për vizatimin e vijave në hartë. Për të nxjerrë vijën e parë përcaktojmë madhësinë e linjës, ngjyrën dhe transparencën. Për të përfunduar vizatimin klikoni dy herë. Linjat e vizatuara mund të fshihen duke klikuar në fushën FSHI VIZATIMIN.

Vizato

Vizato një vijë

TRASHËSIA E VIJËS... 2

NGJYRA E VIJËS

TRANSPARENCA E ...

NDIHMË

Mjet për vizatimin e vijave në hartë. Për të vizatuar një vijë së pari duhet të përcaktoni madhësinë e vijës, ngjyrën dhe transparencën. Pas përcaktimit të parametrave të vijës, filloni të vizatoni duke klikuar në hartë, klikoni dy herë për të përfunduar me vizatimin e vijës.

FSHI VIZATIMIN

Vizato një poligon

Vizato

Vizato një poligon

POLYGON SHAPE

POLIGON

RRETH

KATROR

DREJTKENDESH

ATRIBUTET

TRASHËSIA E VIJËS... 4

NGJYRA E MBUSHJ...

TRANSPARENCA M...

NGJYRA E VIJËS

TRANSPARENCA E ...

Mjet për vizatimin e poligoneve në hartë. Së pari, zgjidhni formën e dëshiruar të poligonit (poligonin, rrethin, katrorin ose drejtkëndëshin) dhe pastaj përcaktoni madhësinë e vijës, errësirën dhe ngjyrën, mbushni transparencën dhe ngjyrën. Pas zgjedhjes së opsioneve të poligonit, përdorni butonin e majtë të mouse-it për të nxjerrë poligonin në hartë. Për të përfunduar vizatimin, klikoni dy herë.

Vendos një shënim


Vizato


Vendos një shënim

EMËRTONI

LLOJI, MADHËSIA

☒
SANS SERIF

☐
ARIAL


☐
TIMES NEW ROMAN

☐
VERDANA

NGYRA E SHKRIMIT

Mjet për vendosjen e shënimeve në hartë. Për të nxjerrë shënime, shkruani tekstin e shënimit, përcaktoni madhësinë e shkronjave, përcaktoni fontin e shënimit dhe ngjyrën. Klikoni në vendin e dëshiruar në hartë për të vendosur shënimin.

Fshi vizatimin




Përdoreni këtë mjet për të fshirë të gjitha tiparet nga shtresa aktive. Nëse nuk aktivizohet asnjë shtresë, të gjitha veçoritë nga shtresa e përkohshme do të hiqen.

Printimi

Printimi ju mundëson të ruani një zonë të zgjedhur të hartës në formën e një skedari PDF ose imazh (PNG ose JPEG). Kur të aktivizohet mjeti i printimit, një drejtkëndësh blu është i mbuluar në hartë. Ky drejtkëndësh përfaqëson zonën që do të printohet. Ju mund të zgjidhni zonën e printueshëm duke lëvizur dhe shkallëzuar drejtkëndëshin. Drejtkëndëshi lëvizet duke klikuar brenda drejtkëndëshit, duke mbajtur butonin e majtë të miut dhe pastaj duke lëvizur miun në drejtimin e dëshiruar. Shkallëzimi bëhet duke klikuar një nga tetë pikat e kontrollit (qarqet blu) dhe duke lëvizur ato duke mbajtur but

onin e majtë të miut.



Mjeti i printimit gjithashtu ka cilësime të ndryshme që mund të zgjidhni.



Titulli i dokumentit

Titulli i dokumentit: printo_20170705_

Titulli do të shfaqet në skedarin e prodhimit dhe do të përdoret si emri i skedarit për shkarkim.

Shkalla

Shkalla: 1:2500000

Zgjedhja e shkallës së hartës. Ju mund të zgjidhni shkallën e dëshiruar nga kjo list opsionesh . Zgjedhja e një shkalle do ta zmadhojë hartën në shkallën e zgjedhur. Përveç kësaj, kombinimi i shkallës do të përditësohet automatikisht nëse harta zmadhohet me anë të ndonjë mjeti tjetër.

Orientimi

Orientimi: ☐ Vertikal
☒ Horizontal

Orientimi i dokumentit gjithashtu ndryshon orientimin e drejtkëndëshit të përzgjedhjes së zonës.

Formati

Formati: ☒ PDF
☐ PNG
☐ JPEG

Përzgjedhja e formatit të daljes. Ju mund të zgjidhni midis PDF dhe dy formate imazhesh (PNG, JPEG).

Madhësia e letres

Madhësia ☒ A4
e letres: ☐ A3
☐ A2

Zgjedhja e madhësisë së letres. Madhësia standarde e letres ofrohet. Përzgjedhja e një madhësie të madhe letre do të prodhojë një skedar të prodhimit me një rezolucion më të madh.

Butoni PRINTO

Fillon gjenerimi i dokumentit me cilësimet e zgjedhura.



Printimi me Vule Digjitale

Shërbimi do të jetë i hapur vetëm për përdoruesit që identifikohen në e-Albania përmes formës së identifikimit 'Identifikimi i punonjësve qeveritarë (GOV). Për punonjësit qeveritar (GOV), në klikim të butonit "Përdor", përdoruesit do i afishohet linku i panelit MAP-Printim në Gjeoportali.

Hapat e procedurës

- Identifikohuni si punonjës qeveritar (GOV) në portalin e-Albania
- Zgjidhni shërbimin "Aplikim për..."
- Klikoni butonin "Përdor"
- Klikoni në linkun e afishuar në faqe për të përcaktuar zonën e dëshiruar në Gjeoportali për firmosje dixhitale të dokumentit
- Klikoni butonin "Dërgo për firmë dixhitale"

Dokumenti me firmë elektronike dërgohet në seksionin "Dokumentet e mia" të hapësira juaj në portalin e-Albania dhe në e-mail.


Printo


Titulli i dokumentit: printo_20240418.

Shkalla: 1:100000

Orientimi:
☐ Vertikal
☒ Horizontal

Formati:
☒ PDF
☐ PNG
☐ JPEG

Madhësia e letrës:
☒ A4
☐ A3

PRINTO

DERGO PER FIRME DIXHITALE

NDIHMË

Mjeti printo gjeneron një hartë dhe e shkarkon atë në kompjuterin e përdoruesit si një skedar. Përdoruesi mund të përzgjedhi emrin e skedarit, madhësinë dhe orientimin letrës si dhe formatin skedarit.

Pas klikimit të “Dërgo për firmë dixhitale”, dokumenti do të dërgohet automatikisht në panelin e administratorit dhe për këtë kërkesë do të gjenerohet një numër reference apo gjurmimi. Përdoruesit, pjesë të GOV, do i shfaqet një mesazh njoftues:


Kërkesa u dërgua me sukses. Do të njoftoheni me e-mail mbi statusin e kërkesës. Numri i referencës: XXXXXXXXXX.

Ky numër reference do të shërbejë si kod identifikues i aplikimit dhe qytetari do të mund të gjurmojë statusin e çështjes në Formën e Gjurmueshmërisë në e-Albania

Linku i dokumentit të firmosur kthehet në ASIG dhe gjithashtu dokumenti me firmë elektronike dërgohet në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira e Përdoruesit në portalin e-Albania dhe në e-mail.

Permalink

Ky mjet përdoret për të krijuar lidhjen me pamjen aktuale të hartës. Ju mund të kopjoni dhe të ndani lidhjen ose kodin QR me përdorues të tjerë.



The screenshot shows a web form for generating a permalink. It includes a URL field with the value 'https://geoportal.asig.gov.al/n', a 'Kopjo linkun' button, a QR code, and three text input fields for email addresses and a message. A 'Dergojeni' button is at the bottom. Numbered annotations point to the following elements:

- 1** URL: Points to the URL text field.
- 2** Kopjo linkun: Points to the 'Kopjo link' button.
- 3** Kodi QR: Points to the QR code.
- 4** Informacione te pergjithshme: Points to the three text input fields for email addresses and a message.
- 5** Dergojeni: Points to the 'Dergojeni' button.

URL

Do të shfaqet lidhja e gjeneruar e pamjes aktuale të hartës.

Kopjo linkun

Duke klikuar këtë buton lidhja do të kopjohet në clipboard.

Kodi QR

Kodi QR do të gjenerohet automatikisht.

Informacione te pergjithshme

Futni adresën e postës elektronike të dërguesit dhe pranuesit. Shkruani mesazhin e duhur dhe pastaj klikoni dërgoni.

Dergojeni

Kliko dërgojeni pas përfundimit të hapave më sipër.

Shto shtresë

